



Nr. 27 Prot.
Tiranë, më 05 Mars 2023

Lënda: Kërkesë për regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë si subjekt zgjedhor dhe dërgimi i dokumentacionit shoqëruar të nevojshëm për regjistrimin në zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023

Drejtuar: Z. Ilirjan Celibashi
Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
TIRANË

I nderuar z. Komisioner,

Në mbështetje të nenit 64 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në zbatim të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, paraqesim kërkesën për regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, si subjekt zgjedhor, në zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023. Kërkesa paraqitet brenda afatit të përcaktuar nga ligji, jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

Në përputhje me pikën 2, të nenit 64 të ligjit nr. 10019/2008, bashkëlidhur lutemi gjeni, dokumentacionin si më poshtë vijon:

1. Vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë – *Vërtetimi datë 01.03.2023 i Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
2. Emrin, mbiemrin dhe adresën e kryetarit të partisë, i cili është personi i autorizuar për të paraqitur kandidatët; emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresën e partisë; specimenin e vulës së partisë; logon e Partisë Demokratike (në print dhe elektronikisht); emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë; dhe emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në – *Shkresa e Partisë Demokratike bashkëlidhur.*
3. Deklaratën e angazhimit solemn për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme, veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale, si dhe përkushtimin për të konkurruar në zgjedhje në mënyrë të ndershme dhe me integritet – *Deklarata bashkëlidhur sipas formatit të miratuar nga KQZ.*
4. Autorizimin e Përgjithshëm – *Autorizimi bashkëlidhur i Kryetarit të Partisë.*

Përsa më sipër, lutemi shqyrtimin e kërkesës dhe në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10019/2008, regjistrimin si subjekt zgjedhor të “Partisë Demokratike të Shqipërisë”.

Me respekt,

Indrit SEFA
Sekretar për Cështjet Ligjore dhe Zgjedhore
Partia Demokratike e Shqipërisë



Nr. 27/1 Prot.
Tiranë, më 05 Mars 2023

Lënda: Dërgohen të dhënat e kërkuara sipas shkronjave “b-dh”, të pikës 2, të nenit 64 të ligjit nr. 10019/2008

Drejtuar: Z. Ilirjan Celibashi
Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
TIRANË

I nderuar z. Komisioner,

Në përputhje me pikën 2 të nenit 64 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku specifikohet se: “2. Për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ: ...b) emrin, mbiemrin dhe adresën e kryetarit të partisë, i cili është personi i autorizuar për të paraqitur kandidatët; c) emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresën e partisë; ç) specimenin e vulës së partisë; d) emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë; dhe dh) emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në”, lutemi gjeni më poshtë të dhënat përkatëse:

1. Sipas vërtetimit të datës 01.03.2023 të Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Kryetari i PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË, Z. Lulzim Basha, me adresë “Selia Qendrore e Partisë Demokratike të Shqipërisë, Tiranë.

2. Të dhënat e subjektit zgjedhor:

a. **Emri zyrtar** i Partisë është: **PARTIA DEMOKRATIKE**

b. **Shkronjat nistore** janë **PD**

c. **Specimenti i vulës** së Partisë është ajo e stampuar më poshtë:



d. **Adresa:** Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr.11, Tiranë.

dh. Logo në print dhe elektronike (CD bashkëlidhur) e Partisë Demokratike:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANË
ZYRA E REGJISTRIT TE PARTIVE POLITIKE

Tiranë më 01.03.2023

VERTETIM

Vërtetojmë se në Rregjistrimin e Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se me urdhër nr. 12 datë 19.12.1990 të Ministrit të Drejtësisë është miratuar krijimi i Partisë “**Partia Demokratike**”, me iniale “**PD**” ose “**PDSH**”.

Kryetar i partisë është z. Lulzim Basha.

E lëshojmë këtë vërtetim në përgjigje të kërkesës së subjektit të interesuar.

SEKRETARE E REGJISTRIT TE PARTIVE POLITIKE

Besa KORBECI





Nr. 27/1 Prot.
Tiranë, më 05 Mars 2023

Lënda: Dërgohen të dhënat e kërkuara sipas shkronjave “b-dh”, të pikës 2, të nenit 64 të ligjit nr. 10019/2008

Drejtuar: Z. Ilirjan Celibashi
Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
TIRANË

I nderuar z. Komisioner,

Në përputhje me pikën 2 të nenit 64 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku specifikohet se: “2. Për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ: ...b) emrin, mbiemrin dhe adresën e kryetarit të partisë, i cili është personi i autorizuar për të paraqitur kandidatët; c) emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresën e partisë; ç) specimentin e vulës së partisë; d) emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë; dhe dh) emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në”, lutemi gjeni më poshtë të dhënat përkatëse:

1. Sipas vërtetimit të datës 01.03.2023 të Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Kryetari i PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË, Z. Lulzim Basha, me adresë “Selia Qendrore e Partisë Demokratike të Shqipërisë, Tiranë.

2. Të dhënat e subjektit zgjedhor:

a. **Emri zyrtar** i Partisë është: **PARTIA DEMOKRATIKE**

b. **Shkronjat** nistore janë **PD**

c. **Specimenti i vulës** së Partisë është ajo e stampuar më poshtë:





d. **Adresa:** Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr.11, Tiranë.

dh. Logo në print dhe elektronike (CD bashkëlidhur) e Partisë Demokratike:



Indrit SEFA
Sekretar për Çështjet Ligjore dhe Zgjedhore
Partia Demokratike e Shqipërisë



Me respekt,

3. Financier i PARTISË DEMOKRATIKE është z. Ilir DERVISHI, me adresë "Rruga e Kavajës, Kompleksi "Square 21", Hyrja 2, Kati 4, Ap. 11" dhe numër kontakti: +355 672083571.
4. Personi përgjegjës për komunikimin e PARTISË DEMOKRATIKE me KQZ është z. Indrit SEFA, me adresë "Rruga e Kavajës, Kompleksi "Square 21", Hyrja 2, Kati 4, Ap. 11" dhe numër kontakti: +355 694060752.



Tiranë, më 05 Mars 2023

DEKLARATA E ANGAZHIMIT SOLEMN E KRYETARIT TË PARTISË POLITIKE

Për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të 14 Majt 2023

Në emër dhe për llogari të Partisë Demokratike të Shqipërisë (PD), që sipas vërtetimit të datës 01.03.2023 të Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka të regjistruar si Kryetar z. Lulzim Basha, i cili ka lëshuar autorizimin e përgjithshëm të datës 18 Mars 2022, unë Enkelejd Alibeaj,

DEKLAROJ:

Angazhimin solemn të Partisë tonë se, pjesëtarët e strukturave drejtuese dhe administrative, të anëtarësisë, kandidatëve për deputetë/ drejtues/ anëtarë të organeve të qeverisjes vendore, deputetë/ drejtues/ anëtarë të organeve të qeverisjes vendore dhe gjithë strukturave të tjera të angazhuara nga subjekti në këto zgjedhje, funksionarë/ ish funksionarë publik do të refuzojnë të marrin pjesë në praktikën e blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme, veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale.

Angazhohemi të zbatojmë rregulla për të gjithë anëtarësinë, administratën dhe ndjekësit tanë që: Të mos premtojnë/ ofrojnë/ japin para, mallra, shërbime dhe/ose nxisin premtime për punësim apo trajtime të tjera të veçanta votuesve dhe/ose të tjerëve, duke përfshirë familjet e votuesve apo komuniteteve të ndryshme apo të veprojnë në mënyrë të tillë që synohet të ndikojë, ose arsyeshëm pritjet të ndikojë në mënyrën se si votuesit japin votën e tyre;

- Të zbatojmë parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore europiane për votim universal, të barabartë, të lirë, të fshehtë, dhe të drejtpërdrejtë;
- Të respektojmë të drejtat dhe liritë politike të shtetasve, organizatave, partive politike, për të promovuar dhe debatuar çështje politike;
- Të mos përfshihemi në praktika kërcënuese ose pengimi për të ushtruar të drejtën e votës dhe shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve.
- Të bëjmë publikën kohë reale pranë KQZ- së dhefaqenzyrtarët e subjektit në politikë çfarëdo lloji donacioni si dhe të refuzojmë dhurime në mjete monetare apo në natyrë që:
 - Tejkalojnë limitin e përcaktuar për donacion;
 - Janë kontribute në para apo në natyrë me prejardhje nga burime të ndaluara që përfshijnë edhe të ardhurat nga krimi, individë, kompani të huaja nga vende me origjinë të dyshimtë/të parajsave fiskale;
 - Janë donacione të cilat nënkuptojnë apo perceptohen si favorizime për dhënie kontrata publike, emërimë në funksione publike apo përfitime të tjera që shkojnë në emër e për llogari të dhuruesit.

Me respekt,

KRYETARI I PARTISË

Me autorizim:

Enkelejd ALIBEAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Model KQZ-04-03

KQZ
U PROTOKOLLUA

Nr. _____ Prot. _____

Datë, më _____, 202_

DEKLARATË
PËR HAPJE LLOGARIE TË POSAÇME BANKARE TË PARTISË POLITIKE

Zgjedhje për Organet e Qeverisjes Vendore

Data e zgjedhjeve 14 Maj 2023

Partia Partia Demokratike e Shqipërisë

PD

(emri zyrtar i partisë)

(shkronjat nistore)

I) TË DHMAT
E LLOGARISË

Numri i llogarisë

Banka

AL8020211013000000101003045

Raiffeisen Bank sh.a.

II) HAPUR
NGA

Kryetari i Partisë

Person i autorizuar nga Kryetari

Indrit Sefa

(Emër Mbiemër)

AUTORIZOJ

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të ngarkuarit e tij për të marrë drejtpërdrejt nga banka të dhëna për të gjitha transaksionet e llogarisë.

Kryetari i Partisë/Personi i autorizuar prej Kryetarit

INDRIT SEFA
(emër, mbiemër)

(nënshkrimi)

06/03/2023
(data dd/mm/vvvv)

